



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 300/1, datë 2.10.2020**

**Mbi korrigjimin e gabimeve materiale në vendimin nr. 300, datë 30.9.2020**

Sot, më 2.10.2020, trupi gjykues, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

bazuar në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, sipas të cilit përcaktohet se:

- “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij”*,

u mbledh për t’u njohur me kërkesën e trupit gjykues, për korrigjimin e një gabimi material në vendimin e subjektit të rivlerësimit, z. Gjijn Gjoni, me nr. 300, datë 30.9.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përkatësisht:

Në fletën 4, në paragrafin 20, ku parashikohet shprehimisht: “*Më tej, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2020, KLGJ-ja ka informuar Komisionin se vendimi nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, i është njoftuar z. Gjijn Gjoni më 30.1.2020, në adresën postare elektronike...*”

Në fletën 6, në footnote, pika 11, parashikohet shprehimisht: “*Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën \*\*\*, datë 11.9.2020, informoi Komisionin se Vendimi i KLGJ-së nr. \*\*\*, datë 30.7.2020 i është njoftuar z. Gjijn Gjoni në datë 30.1.2020....*”

Në këto paragrafe, duhet të korrigjohet data e njoftimit të vendimit të KLGJ-së, z. Gjijn Gjoni, e shënuar 30.1.2020, e cila rezulton të jetë një *lapsus* dhe duhet të korrigjohet duke u saktësuar data **30.7.2020**.

Pas verifikimit, u konstatua se kërkesa e trupit gjykues qëndron, pasi data e njoftimit të vendimit nga KLGJ-ja, subjektit të rivlerësimit z. Gjijn Gjoni, gabimisht është shënuar 30.1.2020. Pasaktësia është dukshëm si pasojë e një gabimi material, në faqen nr. 4, paragrafi 20 dhe në faqen 6, në footnote pika 11, të vendimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Gjijn Gjoni.

Për këto arsye, trupi gjykues,

## **V E N D O S I:**

1. Korrigjimin e gabimit material në faqen nr. 4, paragrafi 20 dhe në faqen 6, në footnote pika 11, të vendimit nr. 300 datë 30.9.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, data e njoftimit të vendimit nga KLGJ-ja, subjektit të rivlerësimit z. Gjin Gjoni, të korrigjohet dhe të zëvendësohet nga data e shënuar 30.1.2020, në datën 30.7.2020.
2. Njoftimin e subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe Vëzhguesit Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Roland ILIA**  
**Anëtar**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*